



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr- 28/2008”, nenit 11, 15 dhe 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të Vendimeve të Kuvendit Komunal në Suharekë të miratuar në vitin 2003, për ndarjen e shpërblimeve të cekura më poshtë, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën -----, miraton këtë:

Projket-V E N D I M

**Për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve
“Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershori”**

Neni 1

Shpërblimi **“Emblema e artë”** i ndahet, **Gafurr ELSHANI** nga Suhareka.

Neni 2

Shpërblimi **“Skënderbeu”** i ndahet: **Xhavit Hazir KELMENDI** dhe **Naser Shefki KELMENDI** që të dytë (dëshmorë).

Neni 3

Mirënjohja **“13 Qershori”** i ndahet këtyre të nominuarëve: **1. Sylejman KODRA** nga Suhareka, **2. Kadri BERISHA** nga fshati Gjinoc **3. Agim KOLOLLI** nga Suhareka, **4. Osman KRASNIQI** nga fshati Reshtan, (postmortum), **5. Qemajl CIKAQI** nga fshati Doberdelan (postmortum), **6. Ibrahim ZAJMI** nga fshati Samadrexhë (postmortum) **7. Ramadan HOTI** nga fshati Samadrexhë (postmortum) **8. Xhemajli BYLYKBASHI** nga fshati Samadrexhë (postmortum) që të gjithë për kontributin e dhënë në fuften e UÇK-së dhe **9. Agim ZENELAJ** nga fshati Savrovë, për kontributin e dhënë gjatë viteve 1990-1999 (në këshillin e financimit).

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Suharekës.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI